

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

DREJTORIA PËR POLITIKË MONETARE DHE HULUMTIM



Treguesit më të rinj makroekonomikë
Pasqyrë e gjendjes aktuale

shkurt 2025

Treguesit më të rinj makroekonomikë

Pasqyrë e gjendjes aktuale - ndikime mbi politikën monetare

Pasqyrë e gjendjes aktuale ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të të dhënave të fundit makroekonomike (nëntor 2024 - janar 2025) dhe një krahasim me parashikimet e fundit makroekonomike (tetor 2024). Me këtë do të përcaktohet se sa korrespondon gjendja aktuale e ekonomisë me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të parashikimit. Rishikimi fokusohet në ndryshimet e supozimeve të jashtme dhe në ecurinë e variablave të brendshme dhe se si këto ndryshime reflektojnë në mjedisin për zhvillimin e politikës monetare.

Parashikimet e fundit të organizatave ndërkombëtare¹ për rritjen ekonomike globale janë pothuajse të pandryshuara, ku edhe më tej pritet stabilizimi në periudhën 2024 – 2026. **Perspektiva afatshkurtra për rritjen globale karakterizohen nga rreziqe të balancuara, ndërsa rreziqet afatmesme janë kryesisht në rënie** dhe lidhen kryesisht me rritjen e pasigurisë rreth politikave tregtare. Rreziqet tjera lidhen me eskalimin e konflikteve dhe tensioneve gjeopolitike, incrinë më të madhe në inflacion, e cila mund të ngadalësojë procesin e lehtësimit monetar, ndryshimet klimatike dhe rritjet më të dobët në ekonominë kryesore. Nga ana tjetër, rreziqet rritëse lidhen kryesisht me procesin më të shpejtë të dezinflacionit dhe mundësinë e rinovimit dhe lidhjes së marrëveshjeve të reja tregtare nga disa prej ekonomive më me ndikim, gjë që do të rriste konsumin dhe besimin afarist.

Shikuar përmes treguesve individualë sasiore të mjedisit të jashtëm domethënës për ekonominë e maqedonase për periudhën 2024 – 2026, vlerësimet për kërkesën e huaj efektive dhe inflacionin janë rishikuar në rënie për të gjithë periudhën e projeksionit. Te kursi valutor, vlera e dollarit amerikan në raport me euron në vitin 2024 ka qenë në një nivel më të lartë se sa ishte parashikur në muajin tetor, tendencë që pritet të vazhdojë edhe në dy vitet e ardhshme, mesatarisht, me pritshmëri për një rritje të vlerës, në vend të zhvlerësimit të pritshëm në parashikimet e tetorit.

Ecuria e çmimeve botërore të mallrave në vitin 2024 ishte e ngjashme me atë të parashikuar në tetor, me rënie të çmimeve për të gjitha produktet, përveç bakrit, i cili pati rritje. Në vitin 2025, vlerësimet janë të rishikuara në rënie të çmimit të metalit dhe grurit, ndërsa të çmimit të naftës dhe misrit ka korrigjime në rritje. Në vitin 2026 kryesisht pritet stabilizim i çmimeve të produkteve primare. Megjithatë, lëvizjet dhe vlerësimet e çmimeve të produkteve primare vazhdojnë të ndikohen fuqishëm nga zhvillimet gjeopolitike, gjë që krijon pasiguri të madhe për dinamikën dhe efektet e tyre në të ardhmen në ekonominë globale dhe vendase.

Përsa i përket **normës së huaj të interesit EURIBOR** me maturim njëmuor, ecuria në vitin 2024 është në përputhje me pritjet e muajit tetor dhe parashikimet e fundit për vitin 2025 dhe 2026 janë rishikuar në rënie, në përputhje me pritjet për ulje të normave të interesit të BQE-së në periudhën e ardhshme. Kështu, në takimin e datës 30.01.2025, BQE-ja vendosi uljen e normave të interesit me 0,25 p.p., në kushtet e inflacionit kryesisht në përputhje me pritshmëritë, por me vlerësime se ai është ende i lartë dhe kushtet financiare mbeten të shtrënguara.

Treguesit e fundit të ekonomisë vendase flasin për një pasqyrë makroekonomike dhe kryesisht në përputhje me parashikimet e muajit tetor. Në tremujorin e tretë të 2024, **rritja reale e PBB-së është 3% me bazë vjetore**, e cila është afër vlerësimit brenda ciklit të projeksionit të tetorit. Të dhënat me frekuencë të lartë për tremujorin e katërt të vitit 2024 aktualisht tregojnë për rritje të mëtejshme të aktivitetit ekonomik në tremujorin e fundit të vitit. Kështu, në

¹ Sipas raporteve të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar "Perspektiva Ekonomike Botërore" dhe "Perspektivat Ekonomike Globale" të Bankës Botërore, të publikuara në janar 2025.

periudhën tetor - nëntor ndërtimtaria dhe qarkullimi i hotelierisë shënoi rritje reale të përshpejtuar dhe zhvillimet në industri në tremujorin e katërt kanë qenë të ngjashme, gjë që mbështet prirjet për një përshpejtim të vogël të rritjes ekonomike në tremujorin e fundit të vitit 2024, ndryshe nga qarkullimi i totalit të tregtisë, e cila vazhdon të rritet për me ritme më të moderuara. **Në dhjetor 2024, norma vjetore e inflacionit ishte 4,4%** dhe siç pritej, mbeti në të njëjtin nivel me muajin e kaluar (4,3%), e ndikuar nga baza më e ulët krahasuese nga e njëjta periudhë e një viti më parë. Dinamika vjetore e rritjes së çmimeve të ushqimeve dhe komponentëve bazë mbetet e qëndrueshme, ndërkohë që rënia e çmimeve të energjisë po ngadalësohet lehtë. **Për tërë vitin 2024, norma mesatare vjetore e inflacionit prej 3,5% është e njejtë me atë të vlerësuarën. Pritjet e konsumatorëve** të dhëna në anketimet e janarit tregojnë për ulje të çmimeve në periudhën e ardhshme. **Diferenca e inflacionit në eurozonë** u ngushtua lehtë në dhjetor, me inflacionin në eurozonë që u përshpejtua pak më shpejt se inflacioni i brendshëm. Rishikimet lidhur me çmimet e importit janë në drejtime të kundërta, gjithsesi tregojnë për rreziqe të balancuara, ndonëse pasiguria për dinamikën e ardhshme të çmimeve të produkteve primare në bursa shkaku i tensioneve gjeopolitike dhe ndryshimeve klimatike është ende e pranishme.

Rezervat valutore në fund të dhjetorit 2024 shënonin 5.019 milionë euro. Analiza e treguesve të përshtatshmërisë të rezervave valutore tregon se ato edhe më tej mbahen në zonën e sigurt. Të dhënat për shkëmbimin e jashtëm tregtar në tetor dhe nëntor 2024 tregojnë për një deficit tregtar për tremujorin e katërt të vitit i cili është më i ulët nga pritjet në përputhje me parashikimin e tetorit. Të dhënat për veprimtarinë e këmbimit në dhjetor 2024 tregojnë flukse neto nga transfertat private që janë në linjë me pritshmëritë për tremujorin e katërt dhe parashikimin e tetorit.


Lidhur me **zhvillimet në sektorin monetar, depozitat** totale në dhjetor 2024 janë më të larta për 11,4% me bazë vjetore, me një rritje vjetore të parashikuar për tremujorin e katërt prej 7,9% sipas projeksionit të tetorit. Totali i kredive të sektorit privat në dhjetor 2024 shënoi një rritje prej 11,2%, me një rritje vjetore të parashikuar për tremujorin e katërt prej 7,5% sipas projeksionit të tetorit. Të dhënat e anketimit për aktivitetin kreditor për tremujorin e katërt të vitit 2024 tregojnë për një lehtësim të caktuar të kushteve për sa i përket ofertës për kredi, më i fortë tek individët dhe pak më i dobët tek bizneset, në kushtet e rritjes së kërkesës. Rritja e kredive të reja vjen që nga fillimi i vitit, që vjen nga dy sektoret (ndërmarrjet dhe amvisëritë). Konkretisht, shumica e totalit të kredive të reja të miratuara për sektorin privat në 12 muajt e fundit, duke përfunduar në muajin nëntor, ka rritje mesatarisht me bazë vjetore.

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën janar - dhjetor 2024 ka shënuar deficit prej 42.045 milionë denarë, ose 94,1% nga deficitin e planifikuar për vitin 2024 (në përputhje me rialokimin e Buxhetit nga nëntori 2024). Deficiti buxhetor financohet nga huamarrja neto e shtetit në tregjet e brendshme dhe të jashtme, me një rritje të njëkohshme të depozitave shtetërore pranë Bankës Popullore.

Treguesit kyç makroekonomik vazhdojnë të lëvizin në linjë me pritjet e parashikimeve të fundit. Norma vjetore e inflacionit për tërë vitin 2024 është në nivel të parashikimit. Pritjet për çmimet e importit në periudhën e ardhshme nuk ndryshojnë mesatarisht nga ato të projeksioneve të tetorit, dhe anketat e janarit të Komisionit Europian tregojnë pritjet e konsumatorëve për ulje të çmimeve në 12 muajt e ardhshëm. Të dhënat e disponueshme me frekuencë të lartë për tremujorin e katërt të vitit 2024 tregojnë për vazhdimin e rritjes ekonomike, e cila sipas parashikimeve të fundit pritet të përshpejtojë lehtë. Tregu valutor mbetet i qëndrueshëm dhe lëvizjet janë të favorshme, gjë që ka ndikuar në një rritje më të fortë të rezervave valutore nga parashikimet për tremujorin e fundit, dhe fluksi i valutave në tregun e këmbimit valutor është në përputhje me pritjet. Në të njëjtën kohë, ecuritë e depozitave dhe kredive në fund të vitit 2024 i tejkaluan pritjet.

Tregues të përzgjedhur makroekonomik/ 1												2023												2024												2025							
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	jan.	shk.	mars	tr.1	prill	maj	qer.	tr.2	korr.	gush.	sht.	tr.3	tet.	nën.	dhj.	tr.4	2023	jan.	shk.	mars	tr.1	prill	maj	qer.	tr.2	korr.	gush.	sht.	tr.3	tet.	nën.	dhj.	tr.4	2024	jan.	
I. Treguesit e sektorit real																																											
Produkti bruto i brendshëm (ritja reale vjetore) ^{1/2}																																											
2.8	1.1	2.9	3.9	-4.7	4.5	2.8					0.2				2.0				2.7				3.1	2.1			1.9				2.8				3.0								
Prodhimi industrial ^{1/3}																																											
norma e ndryshimit (vjetore)																																											
3.4	0.2	5.4	3.7	-9.6	1.5	-0.2	-2.4	0.9	1.3	0.1	-1.8	6.1	3.7	2.7	-1.8	-5.0	4.5	-0.7	9.9	-2.4	-5.8	0.4	0.6	0.6	2.9	0.3	-10.5	-3.0	-1.2	-13.2	-6.5	-7.1	3.8	-1.6	-7.9	-2.1	-1.1	-3.4	-1.4	-2.0	-3.6		
norma mesatare kumulative																																											
3.4	0.2	5.4	3.7	-9.6	1.5	-0.2	-2.4	-0.6	0.1	0.1	-0.4	1.0	1.4	1.4	1.0	0.2	0.7	0.7	1.7	1.3	0.6	0.6	0.6	0.6	2.9	1.5	-3.0	-3.0	-2.6	-4.9	-5.2	-5.2	-3.9	-3.6	-4.2	-4.2	-3.8	-3.8	-3.6	-3.6	-3.6		
Inflacioni ^{1/4}																																											
CPI inflacioni (vjetore) ^{1/5}																																											
-0.2	2.4	0.9	0.4	2.3	4.9	18.7	17.1	16.7	14.7	16.1	13.0	11.3	9.3	11.2	8.4	8.3	6.6	7.7	3.5	3.1	3.6	3.4	3.6	3.2	3.0	4.0	3.4	4.0	4.5	3.2	3.9	3.0	2.2	2.6	2.6	3.5	4.3	4.4	4.1	4.4			
CPI inflacioni (mesatare kumulative)																																											
-0.2	1.4	1.5	0.8	1.2	3.2	14.2	17.1	16.9	16.1	16.1	15.3	14.5	13.6	13.6	12.8	12.2	11.5	11.5	10.7	9.9	9.4	9.4	9.4	3.2	3.1	3.4	3.4	3.6	3.8	3.7	3.7	3.6	3.4	3.3	3.4	3.5	3.5	3.5	3.5				
Inflacioni bazë (mesatare kumulative)																																											
1.3	2.3	1.5	0.5	0.9	2.4	7.1	10.8	10.6	10.2	10.2	10.2	9.9	9.6	9.6	9.3	9.0	8.7	8.7	8.5	8.2	8.0	8.0	8.0	5.1	4.9	5.0	5.0	4.7	4.9	4.9	4.9	5.0	5.0	5.1	5.1	5.2	5.2	5.2	5.2	5.2			
Inflacioni bazë (vjetore) ^{1/5}																																											
1.0	2.8	1.4	-0.3	1.9	2.9	10.8	10.8	10.4	9.5	10.2	10.1	8.9	8.2	9.1	7.4	7.1	6.3	7.0	6.2	6.2	5.4	5.9	5.5	5.1	4.7	5.1	5.0	4.1	5.5	4.7	4.8	5.6	5.3	5.5	5.5	5.9	5.4	5.4	5.6	5.4			
Fuqia punëtore																																											
23.7	22.3	20.6	17.1	16.2	15.4	14.4					13.3				13.1				12.8				13.0	13.1				12.9				12.5				12.3							
Norma e papunësisë ^{1/11}																																											
23.7	22.3	20.6	17.1	16.2	15.4	14.4					13.3				13.1				12.8				13.0	13.1				12.9				12.5				12.3							
II. Treguesit e sektorit fiskal																																											
(Buxheti qendror dhe Buxheti i fondëve)																																											
Gjithësi të hyrve buxhetore																																											
169,356	179,673	188,505	203,822	189,554	218,021	243,085	19,268	18,749	27,991	66,009	21,207	22,294	21,639	65,140	22,594	22,005	21,728	66,326	26,865	24,128	28,660	79,652	277,127	21,447	23,193	24,778	69,418	28,889	23,746	22,245	74,880	28,746	24,342	25,182	78,270	28,011	25,987	29,056	83,054	###			
Gjithësi shpenzimesh buxhetore																																											
185,407	196,561	200,071	217,445	243,421	256,906	278,596	20,681	23,003	25,849	69,533	30,183	24,814	30,202	85,199	26,070	22,007	22,249	70,326	24,370	27,518	41,628	93,516	318,574	26,948	28,896	28,243	84,086	28,633	31,381	24,054	84,068	26,642	26,237	26,579	79,458	26,888	31,536	41,631	100,055	###			
Bilanci buxhetor (para të gatshme bazë)																																											
-16,051	-16,888	-11,566	-13,623	-53,867	-38,885	-35,511	-1,413	-4,254	2,142	-3,524	-8,976	-2,520	-8,563	-20,059	-3,477	-3	-521	-4,000	2,495	-3,390	-12,968	-13,864	-41,447	-5,501	-5,703	-3,464	-14,668	256	-7,635	-1,809	-9,188	2,104	-1,895	-1,397	-1188.0	1,123	-5,549	-12,575	-17,001	-42,045			
Bilanci buxhetor (% nga PBB-ja) ^{1/1}																																											
-2.7	-2.7	-1.8	-2.0	-8.0	-5.3	-4.4	-0.2	-0.5	0.2	-0.4	-1.0	-0.3	-1.0	-2.2	-0.4	0.0	-0.1	-0.4	0.3	-0.4	-1.4	-1.5	-4.6	-0.6	-0.6	-0.4	-1.6	0.0	-0.9	-0.2	-1.0	0.2	-0.2	-0.2	-0.1	0.1	-0.6	-1.4	-1.9	-4.7			
III. Treguesit financiar ^{1/6}																																											
Paraja e gjërë (M4), norma vjetore e rritjes																																											
6.2	5.1	11.8	9.3	6.9	7.0	5.1	4.5	5.7	6.9	6.9	8.6	10.5	11.4	11.4	10.6	9.8	8.8	8.8	8.3	7.4	8.7	8.7	8.7	10.0	9.5	9.5	9.5	9.3	8.5	7.6	7.6	7.6	9.2	8.6	8.6	10.7	10.6	11.4	11.4	11.4			
Totali i kredive, norma vjetore e rritjes																																											
-0.1	5.4	7.3	6.0	4.7	8.3	9.4	8.5	7.7	6.6	6.6	6.3	6.5	6.5	6.5	5.8	6.4	5.8	5.8	5.3	5.2	5.1	5.1	5.1	5.7	6.5	6.1	6.1	6.8	6.8	6.4	6.4	7.3	7.5	7.5	7.5	9.2	9.7	11.2	11.2	11.2			
Totali i kredive të popullsisë																																											
7.0	9.2	10.3	10.5	8.0	7.8	7.3	7.4	7.2	6.8	6.8	6.7	6.5	6.4	6.4	6.4	6.4	6.7	6.4	6.4	6.3	6.5	6.7	6.7	6.7	6.9	7.2	6.8	6.8	7.0	7.0	7.1	7.1	7.5	7.2	7.7	7.7	8.2	8.2	8.8	8.8	8.8		
Totali i kredive të ndërmarrjeve																																											
-5.3	2.3	4.5	1.9	1.1	8.7	11.5	9.7	8.2	6.2	6.2	5.9	6.5	6.5	6.5	5.0	5.8	5.1	5.1	4.1	3.8	3.3	3.3	3.3	4.3	5.9	5.4	5.4	6.6	6.4	5.8	5.8	7.3	8.1	7.5	7.5	10.4	11.5	13.9	13.9	13.9			
Totali i depozitave (me para të depozituara), norma vjetore e rritjes ^{1/7}																																											
6.1	5.0	12.1	9.0	5.7	7.5	4.9	4.5	5.9	6.9	6.9	8.7	10.7	11.6	11.6	11.2	10.2	9.0	9.0	8.3	7.4	9.1	9.1	9.1	10.3	9.6	9.6	9.6	9.6	8.6	7.6	7.6	7.5	9.0	8.4	8.4	10.7	10.4	11.4	11.4	11.4			
Totali i depozitave të popullsisë																																											
2.5	6.1	9.5	7.9	4.6	7.1	5.8	5.9	6.3	8.4	8.4	8.3	8.7	8.8	8.8	8.4	7.0	6.8	6.8	6.8	6.8	7.1	7.9	7.9	7.9	7.8	8.6	8.7	8.7	10.8	10.2	8.9	8.9	9.6	12.0	11.2	11.2	11.7	13.3	13.8	13.8	13.8		
Totali i depozitave të ndërmarrjeve																																											
13.4	2.1	9.5	14.6	10.1	11.6	3.7	2.6	5.7	5.9	5.9	12.0	17.8	19.7	19.7	18.9	19.0	15.7	15.7	14.1	9.8	13.2	13.2	13.2	13.2	15.9	12.3	12.2	12.2	8.0	5.0	4.7	4.7	3.9	3.8	4.7	4.67	10.0	7.0	9.2	9.2	9.2		
Normat e interesit ^{1/8}																																											
Norma e interesit e bonovos të bankës qendrore (në fund të muajit/tremujort/vitit)																																											
3.75	3.25	2.50	2.25	1.50	1.25	4.75	4.75	5.25	5.50	5.50	5.50	5.75	6.00	6.00	6.00	6.15	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.30	6.05	6.1	5.80	5.80	5.55	5.55	5.55
Normat e interesit të huadhenies																																											
në denarë																																											
7.0	6.6	6.1	5.6	5.2	4.9	4.6	5.1	5.1	5.2	5.1	5.2	5.2	5.3	5.2	5.6	5.7	5.7	5.7	5.8	5.8	5.7	5.7	5.4	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.9	5.8	5.9	5.8	5.8	5.7	5.8	5.8			
në valutë të huaj (e agreguar, përfshirë në valutë të huaj dhe në denarë me klauzurë)																																											
5.7	5.3	4.9	4.6	4.3	4.1	4.0	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	5.3	5.3	5.2	5.3	5.2	5.2	5.1	5.2	5.1	5.1	5.1	5.0	5.1	5.0	5.0	5.0	4.9	4.9	4.8	4.9	4.8	4.7	4.7	4.7	4.9			
Normat e interesit të depozitave																																											
në denarë																																											
2.5	2.2	2.0	1.9	1.5	1.2	1.1	1.3	1.4	1.5	1.4	1.6	1.6	1.8	1.7	1.9	2.0	2.0	2.0	2.1	2.2	2.3	2.2	1.8	2.2	2.3	2.3	2.2	2.3	2.3	2.4	2.3	2.4	2.4	2.5	2.4	2.6	2.6	2.7	2.6	2.4			
në valutë të huaj (e agreguar, përfshirë në valutë të huaj dhe në denarë me klauzurë)																																											
1.0	0.9	0.8	0.8	0.6	0.5	0.4	0.6	0.7	0.8	0.7	0.9	0.9	1.0	0.9	1.1	1.2	1.2	1.2	1.2	1.3	1.3	1.4	1.3	1.0	1.3	1.3	1.4	1.4	1.4	1.5	1.5	1.4	1.5	1.5	1.6	1.5	1.6	1.7	1.7	1.7	1.5		
IV. Treguesit e sektorit të jashtëm																																											
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (në milionë euro)																																											
-252.5	-78.3	22.4	-334.7	-318.0	-329.0	-801.3	-26.1	15.5	89.1	78.6	-94.0	21.1	-53.8	-126.7	127.5	25.1	76.5	229.1	-6.1	-1.2	-118.1	-125.4	55.6	-42.0	-81.9	-66.5	-190.4	-50.9	-52.3	-1.7	-104.9	83.4	132.7	47.2	263.3								
Bilanci i llogarisë rrjedhëse (% e PBB-së)																																											
-2.6	-0.8	0.2	-3.0	-2.9	-2.8	-6.1	-0.2	0.1	0.6	0.5	-0.6	0.1	-0.4	-0.9	0.9	0.2	0.5	1.6	0.0	0.0																							

Kërkesa e huaj efektive (ndryshime vjetore në %)




Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Kërkesa e huaj është rishikuar në rënie për tërë periudhën e parashikimeve

...Kryesisht shkaku i vlerësimeve për rritje më të ulët të ekonomisë gjermane².

Inflacioni i huaj efektiv (ndryshime vjetore në %)




Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Korrigjime në rënie ka edhe në **inflacionin efektiv të huaj...**

...si rezultat i pritjeve për një inflacion pak më të ulët te pjesa më e madhe e partnerëve tane importues tregtarë.

Kursi euro/USD-dollar




Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Raporti i **kursit të këmbimit euro/dollar amerikan**, në vitin 2024 ka mbetur i pandryshuar mesatarisht në bazë vjetore, në kundërshtim me zhvlerësimin e pritshëm në parashikimet e tetorit...

...ku pritet forcimi i vlerës së dollarit amerikan në vitin 2025, si dhe zhvlerësim më i vogël në vitin 2026 nga parashikimi i tetorit.

² Rënia e parashikuar e Gjermanisë nga 0,1% në vitin 2024 dhe rritja prej 0,5% dhe 1,1% në 2025 dhe 2026, përkatësisht, kundrejt vlerësimeve për rritje prej 0%, 1% dhe 1,3% në tetor.





Arritjet e çmimeve të produkteve primare në vitin 2024 janë të ngjashme me parashikimet e tetorit, me rënie të çmimit të të gjitha produktet, përveç të bakrit ku u shënuar rritje.

Për vitin 2025, çmimet e metaleve dhe grurit janë rishikuar në rënie, duke reflektuar pritshmëritë për kërkesë më të dobët dhe ofertë më të madhe globale, respektivisht...


...ndërsa vlerësimet për çmimin e misrit dhe naftit janë rishikuar në rritje.

...ndërsa në rastin e misrit ky është rezultat i pritjeve për stoqe më të ulëta globale, ndërsa në rastin e naftës është reflektim i sanksioneve të reja amerikane të vendosura ndaj Rusisë, të cilat synojnë kompanitë energjetike.

Në vitin 2026 pritet stabilizim i çmimeve të produkteve primare.



Euribor-i njëmuor
(mesatarja tremujore, në %)




Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Arritja në **EURIBORIN njëmuor** për vitin 2024 është e ngjashme me parashikimet e tetorit...

...dhe për dy vitet e ardhshme janë bërë korrigjime në rënie të vlerësimeve, në përputhje me pritjet për një ulje më të shpejtë të normave të interesit nga BQE-ja në periudhën e ardhshme.

Indeksi i stresit financiar




Treguesi për stresin global financiar³ vazhdon të tregojë luhatshmëri në tregjet financiare.

³ Tregues KFI IFS (ang. OFR, FSI) e mat stresin sistematik financiar - çrregullime në funksionimin normal të tregjeve financiare. Ai përbëhet nga 33 tregues të luatsëm të tregut financiar, të mbledhur në pesë kategori: Kredi, vlerësim të kapitalit, financim, fonde të sigurta/pa rrezik dhe paqëndrueshmëria. Vlera e treguesit, në ditë të caktuar paraqet nivel mesatar të ponderuar të çdo luhatje të shënuar atë ditë, lidhur me vlerën e tij historike, ku treguesi është pozitiv kur niveli i stresit është mbi mesataren dhe negativ kur niveli i stresit është nën mesataren.

Norma e infalcionit


(kontributet vjetore në inflacionin total, në p.p.)




Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritje të BPRMV-së.

Inflacioni dhe çmimet e ushqimeve dhe energjisë

(ndryshimet vjetore, në %)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës dhe llogaritje të BPRMV-së.

Kontributet në normën vjetore të inflacionit (në p.p.)

Burimi: EShS-ja dhe BPRMV-ja.

Në dhjetor 2024, çmimet e brendshme të konsumit shënuan rritje prej 0,3% në bazë mujore (1,0% në nëntor), kryesisht shkaku i rritjes sezonale të çmimeve të transportit ajror.

Çmimet e produkteve ushqimore u ulën për 0,4%⁴ (rritje prej 2,2% në nëntor), me çmime më të ulëta të perimeve dhe pemëve dhe çmime më të larta të bukës, drithërave dhe vajit.


Çmimet e energjensave shënuan një rritje të vogël mujore prej 0,2%, kryesisht si pasojë e rritjes së çmimeve të derivateve të naftës, në kushtet e rritjes së çmimeve të naftës në bursat botërore të shprehura në euro.

Inflacioni bazë në bazë mujore u rrit për 0,8%, i cili më së shumti erdhi si pasojë e rritjes së çmimeve të komunikacionit ajror, i ndikuar kryesisht nga faktorët sezonalë dhe në një masë më të vogël nga çmimet më të larta të shërbimeve hotelierike dhe aranzhimeve turistike.

Norma vjetore e inflacionit në dhjetor shënon 4,4% dhe u mbajt në nivel të ngjashëm sikur në nëntor (4,3%). Rritja e çmimeve vjen nga komponenta ushqimore dhe bazë, ndërsa çmimet e energjensave vazhdojnë të ulen, por më ngadalë krahasuar me nëntorin. Ndikimi mbi nivelin e normës së inflacionit ka edhe bazë më të ulët krahasuese nga periodha e njëjtë të vitit paraprak, shkaku i masave të ndërmarra në atë kohë për të kufizuar rritjen e çmimeve.


⁴ Vlerësohet se efekti mbi çmimet e masës së ashtuquajtur Shporta e Vitit të Ri ([lidhje](#)), e cila ka qenë në fuqi në periudhën prej 15 dhjetor 2024 deri 15 janar 2025, do të regjistrohet në janar, duke qenë se regjistrimi i çmimeve nga Enti Shtetëror i Statistikave në sektorin e ushqimit, me përjashtime të caktuara, përfundon me 17 të muajit.

Kontributet në normën vjetore të inflacionit (në p.p)




Burimi: EShS-ja dhe BPRMV-ja.

Pritshmëritë e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm (bilanci i përgjigjeve)



Burimi: Komisioni Evropian.

Parashikimet e udhëheqësve të ndërmarrjeve për inflacionin në 3 muajt e ardhshëm (bilanci i përgjigjeve)



Burimi: Komisioni Evropian.

Diferenca e inflacionit në Eurozonë⁵ shënën ulje të lehtë në dhjetor, në kushtet e një përshpejtimi pak më të fortë të inflacionit të Eurozonës nga inflacioni vendas.

Pritjet e konsumatorëve⁶ të dhëna në anketimet e janarit tregojnë për ulje të çmimeve në periudhën e ardhshme.

Lidhur me **sektorin korporativ⁷**, në janar pritjet e inflacionit në periudhën e ardhshme janë më të larta në ndërtimtari, tregti me pakicë dhe industrinë e përpunimit, derisa në sektorin e shërbimeve janë më të ulëta krahasuar me dhjetorin 2024.

Norma vjetore e realizuar e inflacionit në dhjetor është e ngjashme me normën e parashikuar nga cikli i parashikimeve të tetorit. Strukturisht, komponenti ushqimor pësoi rritje më të ulët të çmimeve se sa pritej, rënia e çmimeve të energjisë ishte më e dobët dhe inflacioni bazë ishte pak më i lartë se sa ishte parashikuar. **Për tërë 2024, norma mesatare vjetore e inflacionit është në pajtim me pritjet dhe shënon 3,5%.**


Rishikimet e lëvizjeve të pritshme në supozimet e jashtme hyrëse te parashikimi i inflacionit për vitin 2025 për momentin janë në drejtime të ndryshme, me rishikim në rritje për çmimet e naftës dhe misrit, dhe në rënie për

⁵ Në bazë të indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit,

⁶ Anketa e Komisionit Evropian për optimizmin e konsumit nga janari 2025, në bazë të çështjes për "pritjet e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve në 12 muajt e ardhshëm".

⁷ Anketa për tendencat afariste të Komisionit Evropian në industrinë, tregtinë me pakicë, ndërtimtarinë dhe sektorin e shërbimit.

Çmimet e huaja efektive* dhe të brendshme të ushqimeve dhe pijeve joalkolike (indeks, 2015=100)




* Çmimet e huaja efektive të ushqimeve paraqesin shumë e ponderuar e çmimeve të ushqimeve në vendet që janë partnerë më të rëndësishëm tregtar të Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të ushqimeve.

Burimi: EShS-ja, Eurostat-i dhe llogaritje të BPRMV-së.

çmimet e grurit dhe në një masë më të vogël te inflacioni i huaj efektiv. Njëkohësisht, pasiguria nga dinamika e ardhshme e çmimeve të produkteve primare është ende e lartë.

Paga mesatare e paguar (normat vjetore, në %)




Burimi: EShS-ja.

Në periudhën tetor - nëntor 2024 **paga mesatare neto nominale** shënon rritje të mëtejshme vjetore, por më ngadalë në raport me rritjen e shënuar në tremujorin e tretë...

... nën ndikim të ngadalësimit në industri dhe ndërtim, si dhe në sektoret e shërbimeve⁸, ndërsa në bujqësi është shënuar rritje pak më e lartë e pagave...

Paga mesatare mujore neto e paguar sipas sektorëve (normat nominale vjetore, në %)




Burimi: EShS-ja.

... ndërsa të ngjashme janë edhe zhvillimet te **paga reale neto**, rritja e së cilës gjithashtu përshpejtoi në këtë periudhë.

Ndryshimi i realizuar nominal dhe real i pagave në periudhën tetor-nëntor 2024 është pak më i lartë krahasuar me normat e pritshme për tremujorin e katërt në kuadër të parashikimit të tetorit.

⁸ Ngadalësimi i rritjes së pagave në industrinë e shërbimeve është pjesërisht për shkak të shterimit të efektit mbartës të rritjes prej 10% të pagave në sektorin publik në shtator të vitit të kaluar. Kjo është edhe arsyeja e rritjes së ngadalë të pagave në arsim, përkundër faktit se pagat e të punësuarve në arsimin fillor dhe të mesëm janë rritur për 5% në tetor. Më shumë detaje në këtë [lidhje](#).



Të dhënat me frekuencë të lartë në kahun e ofertës që janë të disponueshme për tremujorin e katërt të vitit 2024 tregojnë kryesisht për lëvizje më të favorshme.

Rezultatet nga hulumtimet e anketave për tremujorin e katërt të vitit 2024 tregojnë për perspektiva më të favorshme në raport me tremujorin e parë të vitit 2023, si dhe në raport me tremujorin paraprak⁹.

Në periudhën tetor-nëntor, **ndërtimtaria** shënoi rritje të lartë reale në bazë vjetore, që paraqet përshpejtim në raport me rritjen e tremujorit paraprak...

...si rezultat i rritjes të kategoritë e ndërtimeve të ulëta dhe të larta, ndërsa të punimet e specializuara ndërtimore¹⁰ ka rënie.


Shërbimet hotelierike në periudhën tetor-nëntor, gjithashtu shënuan rritje të përforcuar vjetore reale, me një rritje solide të numrit të turistëve dhe bujtinave.

Lëvizjet në industri në tremujorin e katërt janë të ngjashme me ato të tremujorit paraprak, pra ende ka një rënie të lehtë të **prodhimit industrial** në bazë vjetore...

...kryesisht për shkak të rënies së minierave dhe furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar, ndërsa rënie minimale ka në industrinë përpunuese.

Arritjet në **tregti** në tremujorin e katërt tregojnë për një rritje reale të lehtë në **qarkullim** në bazë vjetore...

...që vjen si pasojë e lëvizjeve të pafavorshme në tregtinë me pakicë dhe tregtinë me shumicë.



PRODHIMI INDUSTRIAL DHE VEPRIMTARI TË TJERA EKONOMIKE												
	2022				2023				2024			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4
ndryshime reale vjetore në %												
Produkti i brendshëm bruto	2.5	4.0	2.0	2.5	0.2	2.0	2.7	3.1	1.9	2.8	3.0	-
Prodhimi industrial	3.5	1.3	-1.8	-3.4	0.1	2.7	-0.7	0.4	-3.0	-7.1	-2.1	-2.0
Punë ndërtimore të realizuara	-12.2	-5.9	-20.4	-12.8	12.4	-20.8	-8.8	10.7	2.8	26.4	18.2	-
Ndërtim i lartë	-26.6	12.4	-10.0	6.2	12.2	-20.0	-9.8	-18.3	-34.0	-5.3	13.2	-
Ndërtim i ulët	4.2	-13.4	-26.9	-27.2	10.5	-22.6	-7.2	37.1	31.6	48.6	22.7	-
Punë ndërtimore të specializuara	-27.3	-55.3	-21.9	43.5	69.0	10.6	-21.2	11.3	-3.3	98.0	7.0	-
Qarkullimi në tregti - Gjithsej*	9.7	4.0	0.4	-2.7	3.7	-5.2	-6.3	0.2	-3.3	4.0	2.9	0.3
Qarkullim në tregtinë me pakicë*	7.6	6.7	1.9	-3.7	1.4	-8.1	-9.8	-2.8	-4.5	0.9	3.7	-0.6
Qarkullim në tregtinë me shumicë*	11.0	2.4	-1.3	-3.0	3.8	-3.9	-4.4	2.0	-2.6	6.9	4.0	0.5


* Normat reale të mijës janë përllogaritur nga BPRMV-ja, duke përdorur normat nominale të mijës me inflacionin vjetor, i matur sipas shprehimeve të jetesës. Të dhënat e tregtisë për vitet 2020, 2021, 2022, 2023 dhe 2024 janë të dhëna preliminare. Të dhënat e PBB-së për vitin 2023 janë preliminare, ndërsa për vitet 2024 janë të vlerësuara.

Burimi: ESHS-ja dhe llogaritje të BPRMV-së.


⁹ I referohet anketave të zbatuara nga Komisioni Evropian për matjen e besueshmërisë ekonomike të subjekteve në një ekonomi. Treguesi i përbërë i besimit ekonomik fitohet si mesatare e ponderuar e treguesve të besimit për konsumatorët dhe tregusve të besimit për sektorë të caktuar ekonomik (ndërtimtari, industri, tregti me pakicë dhe shërbime).

¹⁰ Punimet e specializuara të ndërtimit janë një kategori e re që ZSHS filloi të publikojë nga maji 2024 në kuadër të të dhënave për punimet e përfunduara të ndërtimit për muajin prill, dhe përfshin kategoritë "prishje dhe përgatitja e kantierit", "instalime elektrike, hidraulike dhe të kanalizimeve dhe punime të tjera të instalimit të ndërtesave", "punime mbarimi në ndërtim" dhe "punime të tjera të specializuara ndërtimi".

Treguesit e veprimtarisë hotelierike
(ndryshimet reale vjetore)



Indicative variables for private consumption
(real annual growth rates, in %)



Source: SSO and NBRNM calculations.

Të dhënat e disponueshme të **konsumit personal**¹¹ për tremujorin e katërt të vitit 2024 kryesisht lëvizin në drejtim pozitiv...

... me rritje reale të pensionet¹², kreditë e popullsisë, pagat, importi i mallrave për konsum të gjërë, prodhimi i brendshëm i mallrave të konsumit dhe të hyrat bruto nga TVSh-ja, me përjashtim të tregtisë me pakicë, e cila shënon një rënie të lehtë.

Lidhur me të dhënat me frekuencë të lartë për **investimet-bruto**¹³ lëvizjet janë kryesisht në drejtim të rritjes...

...me rritje vjetore të përsheptuar të punimeve të përfunduara ndërtimore, kreditë afatgjata të ndërmarrjeve, tatimi mbi fitimin dhe importi i mjeteve të punës, ndërsa rritje shënuan edhe stoqet e produkteve të gatshme. Nga ana tjetër, investime shtetërore kapitale dhe prodhimi i brendshëm i produkteve kapitale shënojnë rënie.


Të dhënat e **tregtisë së jashtme** për periudhën tetor - nëntor 2024 tregojnë për rritje

¹¹ Të dhënat për pagat dhe importin e mallrave për konsum të gjërë janë të periudhës tetor-nëntor 2024, ndërsa të dhënat për kreditë e popullsisë, pensionet, tregtia me pakicë, prodhimi i brendshëm i mallrave të konsumit, importi i mallrave për konsum të gjërë dhe të hyrat bruto nga TVSH-ja i referohen periudhës tetor - dhjetor 2024.

¹² Në tetor 2024 është zbatuar rritje lineare e pensioneve për 2.500 denarë, në vend të korigjimit të mëparshëm të normës së rritjes gjashtëmujore të kostos së jetesës dhe pagës mesatare. Me Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Sigurim Pensional dhe Invalidor, rreth 340.000 pensionistë që fituan të drejtën e sigurimit pensional deri më 31 gusht, janë të përfshirë me rritjen lineare të pensione. Këto ndryshime ligjore parashikojnë edhe një rritje lineare të pensioneve nga 2.500 denarë në mars 2025 (me pagesë në prill) Më shumë detaje në këtë [lidhje](#).

¹³ Të dhënat për punimet e kryera ndërtimore, importin e produkteve për investime dhe stoqet e produkteve të gatshme janë për periudhën tetor-nëntor 2024, ndërsa të dhënat për kreditë afatgjata të ndërmarrjeve, investimeve shtetërore kapitale, prodhimit industrial dhe prodhimit të brendshëm të produkteve kapitale i referohen periudhës tetor-dhjetor 2024.

Indicative variables for investments
(real annual growth rates, in %)



të mundshme të deficitit krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, me një rënie nominale më të lartë të eksporteve në raport me rënien e importeve të mallrave.

Arritjet buxhetore në përputhje me të dhënat fiskale për dhjetor 2024 tregojnë një rritje reale vjetore të mëtëjshme, por dukshëm më të ngadaltë të **shpenzimeve publike** në tremujorin e fundit të vitit.




Deficiti në shkëmbimin e mallrave me vende të huaja në periudhën tetor-nëntor 2024 u rrit për 9,3% në bazë vjetore, në kushte të rënies më të theksuar të eksportit nga rëna e importit të mallrave.

...eksporti i mallrave është më i ulët për 4,8%, kryesisht duke reflektuar eksportin më të ulët të një pjese të kapaciteteve të industrisë automobilistike, gjë që kontribuon në masë të madhe në devijimet në rënie krahasuar me projeksionin e tetorit...


...importi i mallrave realizoi rënie vjetore prej 1%, që gjithashtu është arritje më e dobët nga parashikimi, e ndikuar nga importi më i ulët i lëndëve të para të një pjese të kapaciteteve prodhuese në pronësi të huaj, si dhe importi më i ulët i energjensave.

Të dhënat për periudhën tetor - nëntor 2024 tregojnë aktualisht mundësinë e arritjes së një deficiti tregtar më të ulët se sa pritej për tremujorin e katërt të vitit, sipas parashikimit të tetorit.

Në nëntor të vitit 2024, KREK-u i deflatuar me kostot e jetës shënoi zhvlerësim prej 0,8% në bazë vjetore, ndërsa indeksi i KREK-ut i llogaritur me çmimet e prodhimit të produkteve industriale shënoi mbivlerësim prej 5%.



KREK (kursi real efektiv i këmbimit)
normat vjetore të ndryshimit, në %




...gjatë mbivlerësimit të KKEN-it për 1,5% (kryesisht shkaku i zhvlerësimit të lirës turke dhe të rublës ruse në raport me denarin), rënie e kostove relative të jetës dhe rritje e vogël e çmimeve relative të produkteve industriale.

KREK, pa lëndët e para
normat vjetore të ndryshimit, në %




Në drejtim të njejtë janë edhe ndryshimet e treguesve të KREK-ut të llogaritura pa produktet primare.

Lëvizjet e tregut të këmbimit



Blerja neto në tregun e këmbimit valutor i realizuar në tremujorin e katërt të vitit 2024 arriti në 425 milionë euro, çka tregon se transfertat private janë brenda kufijve të pritshëm për tremujorin e katërt sipas parashikimit të tetorit.

Rezervat devizore bruto
(gjendja, në milionë euro)




Rezervat valutore bruto në fund të dhjetorit 2024 arrijnë 5.019 milionë euro dhe shënojnë rritje krahasuar me fundin e tremujorit të tretë, që kryesisht vjen si pasojë e transaksioneve për llogari të shtetit¹⁴, dhe në masë më të vogël nga blerja e valutave gjatë intervenimeve të Bankës Popullore në tregun valutor.

*Të dhënat e fundit të disponueshme:
30.11.2024
Burimi: BPRMV.


Burimi: BPRMV.

¹⁴ Në 17.10.2024 Ministria e Financave ka marrë hua nga Hungaria Export Import Bank PLC, Budapest mbi bazën e një marrëveshje kredie në shumën 500 milionë euro.


Faktorët e ndryshimit të rezervave devizore në tr.4 2024
(në milionë euro)



Në tremujorin e katërt 2024, në tregun valutor të bankave është regjistruar blerje neto me e ulët valutore, e cila është më e lartë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, në kushte të rritjes së kërkesës dhe të ofertës valutore...




...zhvendosjet e tilla të tregut valutor tërësisht vijnë nga shitja neto më e lartë te kompanitë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.



Instrumentet monetare

(gjendja në fund të muajit, në milionë denarë)



Gjendja e instrumenteve monetare në fund të dhjetorit 2024 shënoi rritje krahasuar me muajin paraprak, që vjen si pasojë e rritjes së sasisë së fondeve të bankave të vendosura në depozita në dispozicion të Banka Popullore.

(gjendja në fund të vitit, në milionë denarë)




Niveli i instrumenteve monetare në fund të dhjetorit është më i lartë në krahasim me nivelin e parashikuar për fundin e tremujorit të katërt të vitit 2024, me një aktivë neto më të lartë të valutore të Bankës Popullore dhe depozita pak më të larta të shtetit, krahasuar me nivelet e parashikuara.

Burimi: BPRMV


Arritjet e parave primare në fund të dhjetorit 2024 janë pak mbi vlerat e parashikuara, sipas parashikimeve të tetorit.

Gjithsej depozitat

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



* Në depozita të sektoreve tjera janë të përfshira depozitat e institucioneve të tjera financiare, depozitat e vetëqeverisjes lokale dhe depozitat e institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërve tek bankat, si dhe depozitat e transferueshme në denarë të institucioneve të tjera financiare dhe të vetëqeverisjes lokale tek Banka Popullore.

Depozitat totale¹⁵ në sektorin financiar në dhjetor 2024 shënuan kryesisht një rritje të nxitur sezonale mujore prej 4,9%, kryesisht si pasojë e rritjes së parave të depozituara, me rritje edhe të dy sektorët (amvisëritë dhe ndërmarrjet). Rrjedhimisht, nga **aspekti valutor** kontributi më i madh i depozitave është në valutën vendase (me para të depozituara).


Depozitat totale në fund të dhjetorit 2024 shënuan rritje krahasuar me fundin e tremujorit paraprak, që është mbi rritjen e pritur për tremujorin e katërt, në pajtim me parashikimin e tetorit.

Norma vjetore e rritjes së depozitave totale në dhjetor 2024 është 11,4% dhe e njëjta është mbi normën e parashikuar për fundin e vitit prej 7,9% sipas parashikimit të tetorit.


Në dhjetor 2024 është realizuar një rritje më e konsiderueshme mujore e **depozitave të amvisërive**, nën ndikim të rritjes më të shprehur të depozitave në valutë vendase, shkaku i rritjes së parave të depozituara, me një ngecje të depozitave në valutë të huaj. **Në bazë vjetore**, depozitat e amvisërive në dhjetor 2024 shënojnë rritje të ndjeshme prej 13,8%.

Depozitat e individëve

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)




Burimi: BPRMV.

¹⁵ Të dhënat i referohen depozitave të sektorit joshitetëror të bankave dhe kursimoreve, mjeteve të institucioneve tjera financiare në llogaritë të BPRMV-ja dhe mejtet e njëjste të vetqeverisjes lokale në llogaritë të BPRMV-ja. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori 2018. Më shumë informacione për ndryshimet metodologjike mund të gjeni në këtë lidhje: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.


Depozitat në denarë dhe në devizë /totali i depozitave të individëve

(pjesëmarrja në fund të muajit, në %)



Pjesëmarrja e depozitave në denarë në strukturën valutore të totalit të depozitave të amvisërive në dhjetor 2024 është në rritje, duke reflektuar trende të favorshme në kursim dhe forcimin e denarizimit.

(pjesëmarrja në fund të vitit, në %)




- Pjesëmarrja e depozitave në denarë (me para të depozituara) të individëve në totalin e depozitave të individëve
- Pjesëmarrja e depozitave në valutë të huaj (me denarë në klauzulë valutore) të individëve në totalin e depozitave të individëve


* Totali i depozitave vetëm tek bankat dhe kursimoret.
Burimi: BPRMV

Paraja e gjerë M4

(kontributet në p.p., ndryshime mujore)



(kontributet në p.p., ndryshime vjetore)




Burimi: BPRMV

Paraja e gjerë e shprehur përmes agregatit monetar më të gjerë M4, ka arritur një rritje të konsiderueshme prej 5.1% në dhjetor 2024, e cila rezulton nga kontributi pozitiv i të gjithë komponentëve nga këndvështrimi valutore dhe maturitetit, por pjesa më e madhe e ndryshimit vjen nga paratë e depozituara.

Në nivel vjetor, paraja e gjerë në dhjetor 2024 shënoi rritje prej 11,4%, që është mbi rritjen e pritur vjetore prej 7,9% për fundin e vitit, sipas parashikimit të tetorit.


Pjesëmarrja e parasë së gjerë M4 në denarë në totalin e M4

(të dhënat në fund të muajit, në %)




Pjesëmarrja e pjesës së denarit në totalin e parasë së gjerë M4, në muajin e fundit të vitit shënon rritje dhe është mbi vlerën e parashikuar.

(të dhënat në fund të vitit, në %)



Gjithsej kreditë


(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



Totali kredive në dhjetor shënoi rritje mujore prej 2,7%.

Në fund të vitit 2024, totali kredive¹⁶ shënoi rritje në krahasim me fundin e shtatorit, që është mbi rritjen e pritur për tremujorin e katërt të vitit, sipas parashikimit të tetorit.


(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



Norma vjetore e rritjes së totalit të kredive në dhjetor arrin 11,2%, me rritje vjetore të parashikuar për fundin e vitit 2024 prej 7,5%.


¹⁶ Rritja e kredive të ndërmarrjeve në një pjesë është e lidhur me miratimin e kredisë në shumë më të madhe të ndërmarrjes publike të sektorit energjetik.

**Kredi të reja të sektorit privat, 12m
mesatarja lëvizëse, normat vjetore të
rritjes**




Shuma e totalit të kredive të reja të miratuara për sektorin privat në 12 muajt e fundit, në nëntor 2024, shënoi rritje të moderuar me bazë vjetore, si rezultat i rritjes së kredive në të dy sektorët (ndërmarrje dhe amvisëri).

**Kredi të reja të ndërmarrjeve, 12m
mesatarja lëvizëse, normat vjetore të
rritjes**



**Kredi të reja të amvisërive, 12m
mesatarja lëvizëse, normat vjetore të
rritjes**



**Raporti ndërmjet kredive dhe depozitave totale
(të dhënat mujore, në %)**




Treguesi për shfrytëzimin e potencialit depozitues të bankave për kreditimin e sektorit privat në muajin dhjetor ishte 81,4%, që është pothuajse në nivelin e vlerës së parashikuar të këtij treguesi për fundin e tremujorit të katërt 2024 sipas parashikimit të tetorit.

(të dhënat vjetore, në %)



Burimi: BPRMV


Normat e interesit të gjithsej deponitave
(të dhëna mujore, në %)



Burimi: BPRMV

Në muajin e fundit të vitit, **norma e interesit të totalit të deponitave valutore**¹⁷ u mbajt në nivel të nëntorit 2024, ndërsa **norma e interesit të totalit të deponitave në denarë** shënoi lëvizje të lehtë rritëse, por pa ndryshime të konsiderueshme në diferencën e normës së interesit. Normat e interesit të **deponitave të reja në denarë** mbetën të pandryshuara, me një lëvizje të lehtë rënëse të **deponitave të reja valutore**,¹⁸ e cila rrini diferencën e interesit për 0,1 p.p...

Normat e interesit të deponitave të individëve
(të dhëna mujore, në %)




Burimi: BPRMV

...dhe lëvizje të ngjashme ka pasur edhe në normat e interesit për deponizat totale dhe deponizat e reja në sektorin "amvisëri".

¹⁷ Të dhënat për normat e interesit janë në pajtim me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori 2018. Më shumë informacione për ndryshimet metodologjike mund të gjeni në këtë lidhje: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nspk.


¹⁸ Lidhur me normat e interesit të kredive të reja duhet të merret parasysh se këto lëvizje janë karakteristike për ato. Ndryshueshmëria e normave të interesit të kredive të reja vjen nga fakti se ato janë të kushtëzuara nga vëllimi i kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshon) dhe norma e tyre e interesit.

Normat e interesit të gjithsej kredive, sipas sektorëve
(të dhëna mujore, në %)



Në muajin e fundit të vitit, lëvizje rënëse është vërejtur edhe në normat e interesit të **totalit dhe të kredive¹⁹ të reja të ndërmarrjeve dhe amvisërive**, në krahasim me muajin paraprak.


Normat e interesit bazë të BPRMV-së dhe BQE-së (në %) dhe diferenca e tyre (në p.p.)



Në janar, diferenca në normat bazë të interesit të Bankës Popullore dhe të Bankës Qendrore Europiane (BQE) është zgjëruar (për 0,25 p.p.) shkaku i uljes së normave bazë të interesit nga ana e BQE-së nga fundi i muajit.

¹⁹ Lidhur me normat e interesit të kredive të reja duhet të merret parasysh se këto lëvizje janë karakteristike për ato. Ndryshueshmëria e normave të interesit të kredive të reja vjen nga fakti se ato janë të kushtëzuara nga vëllimi i kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshohet) dhe norma e tyre e interesit.


Të hyrat dhe shpenzimet buxhetore (kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.)



Në dhjetor 2024, të hyrat në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve) shënojnë rritje të lehtë vjetore, me një rritje të moderuar të të hyrave nga kontributet dhe të hyrjeve tjera, ndërsa të hyrat nga tatimet dhe të hyrat jotatimore shënuan rënie të moderuar. Shpenzimet buxhetore shënojnë ngecje në bazë vjetore, kështu që shpenzimet aktuale më të larta (kryesisht nga transferimet e larta) tërësisht janë neutralizuar nga rënia e shpenzimeve kapitale²⁰.

Në periudhën janar - dhjetor 2024, të hyrat totale buxhetore realizuan rritje për 10,3%, ndërsa të dalurat buxhetore janë më të larta për 9,1%...

Realizimi i Buxhetit, sipas kategorive, (Buxheti qendror dhe fondet), në përqindje nga plani vjetor



Burimi: Ministria e Financave dhe Ilogaritjet e BPRMV-së.

...deficiti i realizuar buxhetor në shumë prej 42.045 milionë denarë²¹ gjatë tërë vitit 2024 paraqet 94,1% të deficitit të planifikuar për vitin në pajtim me rialokimin e Buxhetit²²...


²⁰ Pjesërisht si rezultat i bazës më të lartë të krahasimit që nga dhjetori 2023, për shkak të shumave më të larta të paguara ndaj Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore (NPRrSh) për ndërtimin e autostradave në korridoret 8 dhe 10e.

²¹ Për llogaritjen e pjesëmarrjes së deficitit buxhetor në PBB-në shfrytëzohen të dhënat e fundit të rishikuara për PBB-në të EShS-së për vitet 2022 dhe 2023 dhe arritjet e tre muajve të parë të vitit 2024 (përfshirë edhe të dhënat e rishikuara për gjysmën e parë të vitit). Për tremujorin e fundit të vitit 2024, përdoret një shumë nominale e PBB-së e përfutur duke aplikuar normën e parashikuar të rritjes për këtë tremujor.


²² "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 250 nga 11.12.2024

Financimi i bilancit buxhetor

(në milionë denarë)



...i njejtë është financuar me debitim neto të shtetit në tregun vendas dhe të huaj²³, me rritje të depozitave të shtetit te Banka Popullore.




* Ndryshimi pozitiv: ulje e depozitave tek BPRMV, ndryshimi negativ: rritje e depozitave tek BPRMV.

Burimi: Ministria e Financave.

Normat e interesit të letrave me vlerë shtetërore


në përqindje



Burimi: Ministria e Financave.

Në janar 2025, në ankande të rregullta u emetuan bono thesari dymbëdhjetëmujore, bono thesari trevjeçare dhe bono thesari pesëmbëdhjetëvjeçare pa klauzolë valutore, me norma interesi të pandryshuara 3,8%, 3,95% dhe përkatësisht, 5,6%.

²³ Hyrja e kështit të dytë prej 155 milionë eurosh nga programi PLL (Linja e Parandalimit dhe Likuiditetit) të Fondit Monetar Ndërkombëtar në janar 2024 dhe një hyrje prej 50 milionë eurosh nga një kredi nga Komisioni European në maj 2024. Në mars 2024, shteti pagoi një kësht prej rreth 70 milionë eurosh për obligacionin e njohur si "Namensschuldverschreibungen", ose NSV. Në tetor 2024 u realizua një hyrje prej 500 milionë eurosh nga marrëveshja e huasë me Hungarian Export Import-Bank PLC, Budapest.



Rritje e **borxhit publik**²⁴ në fund të tremujorit të katërt 2024, e ndikuar nga rritja e borxhit publik të brendshëm dhe të jashtëm²⁵.

Burimi: Ministria e Financave dhe përlogaritjet e BPRMV-së

²⁴ Borxhi publik është definuar me Ligjin për Borxhin Publik ("Gazeta Zyrtare e RM" numër 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019) sipas të cilës paraqet përmblendje të borxhit shtetëror dhe borxhit të ndërmarrjeve publike të bazuara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, si dhe shoqëritë tregtare që janë me pronësi të plotë ose të shumicës së shtetit ose të komunave, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit.

²⁵ Për llogaritjen e pjesëmarrjes në borxhin publik si përqindje nga PBB-ja shfrytëzohen të dhënat e fundit të rishikuara në rritje për PBB-në të EShS-së për vitet 2022 dhe 2023 dhe arritjet e tre muajve të parë të vitit 2024 (përfshirë edhe të dhënat e rishikuara për gjysmën e parë të vitit). Për tremujorin e fundit të vitit 2024, përdoret një shumë nominale e PBB-së e përfutur duke aplikuar normën e parashikuar të rritjes për këtë tremujor.

Shtojca 1: Kategoritë treguese të konsumit personal dhe investimeve bruto

KATEGORITË INDIKATIVE PËR KONSUMIN PRIVAT															
	2022				2023				2024						
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	tet	nën.	dhj.
	ndryshime reale vjetore në %														
Qarkullimi në tregtinë me pakicë*	7.6	6.7	1.9	-3.7	1.4	-8.1	-9.8	-2.8	-4.5	0.9	3.7	-0.6	-0.8	-2.7	1.7
Të ardhurat bruto nga TVSh-ja*	29.2	9.5	3.7	-7.7	-15.0	-9.5	-10.7	-1.5	1.6	5.5	4.5	0.2	4.8	-3.1	-1.5
Importi i mallrave për konsum të gjërë*	-2.8	-1.5	-2.1	-9.9	2.0	4.7	1.4	14.5	15.4	4.2	8.6	-	1.6	0.6	-
Prodhimi vendor i mallrave të konsumit	2.2	-1.2	3.2	-3.6	6.4	4.9	-7.5	-1.2	-8.5	-7.1	5.4	1.3	1.1	-2.7	5.9
Kreditë konsumatore*	-0.5	-5.6	-9.2	-9.3	-6.6	-2.4	0.0	3.1	2.9	3.9	5.1	4.3	4.7	3.9	4.3
Paga mesatare neto*	0.0	-1.7	-4.6	-4.6	-2.8	3.6	6.6	12.8	12.5	9.6	9.0	-	4.8	5.0	-
Transferrat private neto*	9.8	24.1	11.8	5.1	11.3	-8.4	-10.4	-1.4	-11.8	-11.3	-5.8	-	-	-	-
Pensionet*	-3.4	-1.0	-10.4	-4.9	-2.5	1.3	9.9	13.4	17.0	10.1	9.5	13.0	15.9	15.5	7.8

* normat reale të rritjes janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës.
Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritje të BPMVP.

KATEGORITË INDIKATIVE PËR INVESTIMET															
	2022				2023				2024						
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	tet	nën.	dhj.
	ndryshimet reale vjetore në %, përveç IHD-ve ku ndryshimet reale janë në milionë denarë														
Importi i mjeteve për punë*	6.9	5.6	10.9	-1.3	-3.9	-1.9	-5.5	3.0	10.9	3.4	-1.8	-	-6.2	10.7	-
Punë ndërtimore të realizuara**	-12.2	-5.9	-20.4	-12.8	12.4	-20.8	-8.8	10.7	2.8	26.4	18.2	-	16.3	28.3	-
Prodhimi vendor i produkteve kapitale	0.9	3.3	18.6	3.7	6.7	8.2	6.7	17.9	10.6	-2.8	0.9	-9.9	0.1	-11.1	-20.1
Investime kapitale shtetërore*	-16.4	25.0	-47.3	55.6	-6.8	313.0	29.1	-4.0	27.5	-65.8	-25.8	-31.1	-12.7	-3.5	-39.9
Investime të huaja direkte***	9616.2	-6348.6	10624.7	262.4	247.6	-2198.3	-9252.6	-2416.1	8187.8	5037.9	11534.9	-	-	-	-
Kredi afatgjatë të ndërmarrjeve*	2.2	-2.2	-6.5	-6.7	-5.0	1.2	3.4	3.9	2.8	4.8	5.8	9.4	8.8	9.7	9.4
Stoqet e produkteve të gatshme	11.5	9.2	11.1	10.5	-3.1	-2.4	-3.8	-0.6	2.0	4.5	1.0	-	-	-	-

* normat reale të rritjes janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, i matur sipas shpenzimeve të jetesës.
** normat reale të rritjes janë fituar duke përdorur normën e rritjes së deflatorit të shpenzimeve për ndërtimin e banesave të reja.
*** vlerat reale janë përlogaritur nga BPRMV-ja, duke përpjesëtuar vlerat nominale me nivelin e indeksit të çmimeve të konsumit (viti bazë: 2023= 100).
Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritje të BPMVP.